



Republika e Kosovës  
Republika Kosova – Republic of Kosovo



Komuna e Prishtinës  
Opština Priština –Municipality of Prishtina

<b>Datë/a:</b>	08.04.2021
<b>Referenc-ë:</b>	
<b>Për/ Za/ To:</b>	“Embassy of the Kingdom of the Netherlands in Kosovo”
<b>Përmes/Preko/Through:</b>	Drejtoris së Shërbimeve Publike, Mbrojtjes dhe Shpëtimit
<b>Nga/ Od/ From:</b>	Punoi: Liridona Kastrati, zyrtare për hapësira publike Kontrollooi: Habib Qorri, udhëheqës i sektorit
<b>Tema/ Subjekat/Subject:</b>	<b>Pëlqim</b>

Drejtoria për Shërbime Publike, Mbrojtje dhe Shpëtim ka pranuar kërkesën përmes kanalit zyrtar nga “Embassy of the Kingdom of the Netherlands in Kosovo” me përfaqësuese Burbuqe Brahimë me të cilën kërkohet që me datë 27 Prill 2021 të bëhet shfrytëzimi i hapësirës publike me qëllim të shënimit të Ditës së Mbretit të Holandës.

Për shënimin e kësaj dite do të bëhet ngasja e biçikletave nga Dardania deri në Dragodan ku nisja do të bëhet në ora 16:00.

Drejtoria pas shqyrtimit të kërkesës, duke u bazuar në nenin 4, pika 2, shkronjë i) të Rregullores për “Vendosjen, Ndërtimin dhe Largimin e Objekteve të Përkohshme në Pronën Publike” me nr.01-110-157481, jep pëlqimin për shfrytëzimin e hapësirës publike nga Dardani deri në Dragodan me 27 Prill 2021 sipas kërkesës së parashtruar.

Kushtet e pëlqimit:

- Të respektohen të gjitha masat dhe rregullat e përcaktuara nga Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike të Kosovës për organizimin dhe mbajtjen e aktiviteteve publike;
- Varësisht nga vendimet e IKSHP-së dhe Ministrisë për parandalimin e përhapjes së pandemisë, kushtet e pëlqimit mund të ndryshohen apo të bëhet pezullimi.

Vërejtje: pala është e obliguar që të respektojë të gjitha pikat e cekura më lartë, në të kundërtën pëlqimi konsiderohet i pezulluar.